Vendim nr. 89, datë 06.10.2026

(V-89/26)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fiona Papajorgji, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, Asim Vokshi, Ilir Toska, anëtarë, me sekretare Farisja Idrizaj, në datën 06.10.2026 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 9 (A) 2026 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: **ANGJELINA HAXHI,** përfaqësuar nga avokati Thomas Dhimolea, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR:

AVOKATURA E SHTETIT, përfaqësuar nga avokatja e shtetit Denisa Skënderaj.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-3009, datë 16.07.2025 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

Konstatimi i cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm të çështjes nr. 21246-00770-30-2025 pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe përshpejtimi i procedurave të shqyrtimit pranë saj sipas afatit ligjor të posaçëm 30-ditor nga data e hyrjes në fuqi të vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

Ngarkimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me shpenzimet gjyqësore për shërbimin ligjor nga avokati në shumën 50.000 lekë.

BAZA LIGJORE: **Neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *(Kushtetuta);* neni 6, pika 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut**

(*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar *(Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkueses Angjelina Haxhi (*kërkuesja*), e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Avokaturës së Shtetit, i cili ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Shtetasit S.H. dhe A.H. (nënë e bir), nëpërmjet kontratës së privatizimit të vitit 1993, kanë përfituar në bashkëpronësi, me nga 1/2-ën pjesë secili, një pasuri të paluajtshme të ndodhur në Vlorë. Me kontratën e shitjes të datës 06.12.2002, shtetasi A.H. i ka shitur kërkueses Angjelina Haxhi, motrës së tij, pjesën takuese prej 1/2-ës në këtë pasuri. Në datën 24.09.2019, kur është pajisur me certifikatë pronësie, kërkuesja ka konstatuar se si bashkëpronare e pasurisë figuronte edhe shtetasja M.D.(H.), motra e saj. Për këtë arsye, kërkuesja i është drejtuar gjykatës me padi, duke kërkuar detyrimin e së padituës M.D.(H.) për ta njohur pronare të pjesës së pasurisë që e paditura ka përfituar nëpërmjet kontratës së privatizimit të datës 06.10.1993, konstatimin e pavlefshmërisë së pjesshme absolute të akteve të praktikës së privatizimit, përkatësisht të formularit nr. 2 dhe, për rrjedhojë, të kontratës së privatizimit, rregullimin e pasojave të pavlefshmërisë, si dhe fshirjen e emrit të së padituës nga kartela e pasurisë së paluajtshme.

2. Në datën 21.01.2022, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, është regjistruar çështja civile me palë dhe objekt si më sipër. Në seancën gjyqësore të datës 06.11.2024 ajo gjykatë, bazuar në nenin 299, shkronja "ç", të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*), ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes, për shkak të mosparaqitjes së paditëses (kërkueses) dhe përfaqësuesit të saj në seancë, megjithëse ata kishin dijeni për zhvillimin e saj nga seanca e mëparshme. Kundër këtij vendimi kërkuesja ka paraqitur ankim të veçantë, mbi bazën e të cilit, në

datën 18.02.2025, çështja është regjistruar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me nr. 21246-00770-30-2025.

3. Duke pretenduar se ankimi i veçantë duhej të shqyrtohej brenda 30 ditëve, sipas nenit 470, pika 3, të KPC-së, dhe në kushtet kur çështja nuk ishte shqyrtuar ende, në datën 04.06.2025 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave të gjykimit në apel.

4. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-3009, datë 16.07.2025, ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Sipas atij kolegji, referuar edhe argumenteve të parashtruara në mendimin me shkrim të gjyqtarit relator, vonesa në shqyrtimin e çështjes së kërkueses nuk ka ardhur si pasojë e mungesës së vullnetit për gjykimin e saj, por për shkak të një problematike të përgjithshme që tejkalon rastin konkret. Konkretisht, sipas Kolegjit Civil, Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm ka një ngarkesë të jashtëzakonshme çështjesh dhe janë në pritje për gjykim çështje të regjistruara gjatë viteve 2017-2025, të cilat planifikohen dhe shqyrtohen sipas rendit kronologjik, duke mbajtur parasysh përparësinë në trajtim. Kolegji Civil ka vlerësuar se mosveprimi i gjykatës së apelit nuk lidhet me shkaqe subjektive, vlerësime ose qëndrime abuzive të gjyqtarit relator, i cili ndjek kriterin e vjetërsisë së regjistrimit të çështjeve dhe është duke shqyrtuar dhe planifikuar çështje të vitit 2017. Duke pasur parasysh numrin e lartë të çështjeve në pritje për gjykim, numrin e reduktuar të gjyqtarëve, datën e regjistrimit të çështjes së kërkueses (18.02.2025), si dhe shkaqet objektive të lidhura me ngarkesën e gjyqtarit relator, Kolegji Civil ka arritur në përfundimin se nuk është shkelur afati i arsyeshëm, pasi, sipas tij, në përllogaritjen e këtij afati duhet të mbahen parasysh rrethanat që evidentojnë pamundësinë objektive për procedimin e çështjes.

5. Në datën 26.01.2026, përmes shërbimit postar, kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të pasqyruar në pjesën hyrëse të këtij vendimi. Ky ankim, pasi është plotësuar sipas kërkesave të nenit 27 të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 03.02.2026. Kolegji i Gjykatës, me vendimin e datës 23.04.2026, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

6. ***Kërkuesja,*** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar *e drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, pasi:

6.1. Sipas nenit 470, pika 3, të KPC-së, ankimet kundër vendimeve të ndërmjetme shqyrtohen brenda 30 ditëve nga regjistrimi i tyre, ndërsa neni 399/2, pika 2, i KPC-së lejon kërkimin e konstatimit të tejzgjatjes së procedurave edhe përpara kalimit të afateve të përgjithshme të parashikuara nga ky kod. Po ashtu, vendimi nr. 78, datë 30.05.2019 i Këshillit të Lartë Gjyqësor "Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit" (*vendimi i KLGJ-së nr. 78/2019*) parashikon shqyrtimin me përparësi të çështjeve për shkak të natyrës së tyre, ku përfshihen edhe ankimet kundër vendimeve për kthimin e akteve ose pushimin e gjykimit nga gjykata e shkallës së parë. Pavarësisht se kërkuesja ka paraqitur disa kërkesa për përshpejtim në gjykatën e apelit, ankimi i saj nuk është shqyrtuar.

6.2. Në analizën e kritereve për përcaktimin e kohëzgjatjes së arsyeshme të gjykimit, sjellja e kërkueses nuk është bërë shkak për vonesën e shqyrtimit të çështjes. Vendimi për pushimin e gjykimit nga gjykata e shkallës së parë është i paligjshëm, pasi mosparaqitja e kërkueses në seancë ka qenë e justifikuar dhe, për më tepër, gjykata nuk ka mbajtur parasysh praktikën e Gjykatës së Lartë, sipas së cilës mosparaqitja në seancë gjyqësore, pa dhënë shkaqe të arsyeshme, nuk mund të interpretohet *a priori* si mungesë interesi për gjykimin e çështjes. Për sa i përket kompleksitetit, çështja nuk paraqet vështirësi të veçanta as në aspektin faktik e provues, as në atë juridik.

6.3. Në lidhje me sjelljen e autoriteteve, ato nuk kanë përmbushur detyrimin për organizimin e një sistemi gjyqësor efikas, të aftë për të garantuar përfundimin e proceseve gjyqësore brenda një afati të arsyeshëm. Për më tepër, për çështje të kësaj natyre jo vetëm që parashikohen afate të posaçme shqyrtimi, por KLGJ-ja ka përcaktuar trajtimin e tyre me përparësi. Për sa i përket rëndësisë së asaj që rrezikon kërkuesja, vonesa në shqyrtimin e ankimit të veçantë kundër vendimit për pushimin e gjykimit sjell pasoja të drejtpërdrejta për vijimin e procesit të themelit. Ky proces është regjistruar në shkallë të parë që në datën 21.01.2022 dhe nuk mund të vijojë për sa kohë që ankimi i veçantë, i regjistruar në gjykatën e apelit në datën 18.02.2025, nuk merret në shqyrtim nga ajo gjykatë.

7. ***Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit,*** ka prapësuar se:

7.1. Në analizë të kritereve të evidentuara nga Gjykata për vlerësimin e kohëzgjatjes së arsyeshme të procesit, sikundër ka arsyetuar edhe Gjykata e Lartë, mosveprimi i gjykatës së apelit nuk ka ardhur për shkaqe subjektive, vlerësime ose qëndrime abuzive të gjyqtarit relator. Në rastin konkret janë marrë të gjitha masat e nevojshme organizative, duke u përcaktuar kritere transparente dhe objektive për marrjen në gjykim të çështjeve, sipas radhës së vjetërsisë së regjistrimit të tyre. Duke mbajtur parasysh numrin e lartë të çështjeve në pritje për gjykim, numrin e reduktuar të gjyqtarëve, datën e regjistrimit të çështjes së kërkueses në gjykatën e apelit, si dhe shkaqet objektive që lidhen me ngarkesën e gjyqtarit relator, nuk rezulton të jetë shkelur afati i arsyeshëm, pasi këto rrethana dëshmojnë pamundësinë objektive për procedimin e çështjes.

7.2. Çështja e kërkueses i është dorëzuar fizikisht gjyqtarit relator nga sekretaria gjyqësore në muajin shkurt të vitit 2025, kohë në të cilën në gjykatën e apelit ndodheshin në pritje për gjykim çështje civile të regjistruara në vitin 2017, përfshirë edhe çështje për të cilat parashikohen afate më të shkurtra gjykimi. Gjatë viteve 2023 dhe 2024, gjyqtari relator ka gjykuar rreth 750 çështje, pa llogaritur masat e sigurimit personal në lëndë penale, urdhrat e mbrojtjes dhe pjesëmarrjen për plotësimin e trupave gjykues. Mosplanifikimi i çështjes së kërkueses për gjykim është pasojë e ngarkesës së lartë dhe e pamundësisë objektive për ta shqyrtuar, dhe jo pasojë e neglizhencës ose e ndonjë veprimi të qëllimshëm të trupës gjykuese. Afatet e gjykimit nuk mund të shihen të shkëputura nga realiteti objektiv në të cilin ndodhet gjykata e apelit. Përshpejtimi i një çështjeje në këto rrethana do të cenonte barazinë në radhën e trajtimit të çështjeve të tjera që ndodhen në kushte të ngjashme.

7.3. Për sa i përket rëndësisë së asaj çfarë rrezikon kërkuesja për shkak të vonesës në gjykimin e çështjes, ajo nuk ka argumentuar dhe provuar ekzistencën e një rreziku për interesat e saj, natyra dhe rëndësia e të cilit të justifikojnë trajtimin me përparësi të çështjes. Mosmarrëveshja lidhet me interesa vetjakë, konkretisht me të drejtën e pronës, por jo me interesa jetësorë të një natyre të tillë që të kërkojë domosdoshmërisht shqyrtimin me prioritet nga gjykata.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për kriteret e pranueshmërisë së kërkesës

8. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

9. Duke pasur parasysh natyrën kumulative të kritereve të pranueshmërisë, si dhe jurisprudencën e konsoliduar të saj, Gjykata vëren se kriteret *ratione personae, shterimi i mjeteve juridike efektive* dhe *ratione temporis* në rastin konkret janë të përmbushura. Në lidhje me to nuk rezulton të ketë çështje që kërkojnë analizë të mëtejshme dhe as nuk evidentohen rrethana faktike që mund të çojnë Gjykatën në një qëndrim të ndryshëm në këtë drejtim.

10. Për sa i përket legjitimimit *ratione materiae,* Gjykata vëren se kërkuesja ka pretenduar cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor* për shkak të *mosgjykimit të çështjes së saj brenda një afati të arsyeshëm* nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm. Ky pretendim, për nga natyra dhe argumentet e parashtruara në mbështetje të tij, hyn në juridiksionin kushtetues, në kuptim të neneve 42 dhe 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, ndaj në vijim do të analizohet bazueshmëria e tij në themel.

B. Për themelin e pretendimeve

B. 1. Për cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm

11. Kërkuesja ka pretenduar se ankimi i saj i veçantë kundër vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë është regjistruar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në datën 18.02.2025 dhe megjithëse duhej të shqyrtohej brenda 30 ditëve, sipas nenit 470, pika 3, të KPC-së, ai vijon të jetë i pashqyrtuar. Sipas saj, pavarësisht kërkesave të paraqitura për përshpejtimin e gjykimit dhe faktit se çështje të kësaj natyre duhet të shqyrtohen me përparësi, sipas vendimit nr. 78/2019 të KLGJ-së, ankimi i veçantë nuk është marrë në shqyrtim. Po sipas kërkueses, vonesa nuk është shkaktuar nga sjellja e saj ose kompleksiteti i

çështjes, ndërsa autoritetet nuk kanë përmbushur detyrimin për garantimin e një sistemi gjyqësor efikas. Ajo ka theksuar se mosshqyrtimi i ankimit të veçantë pengon vijimin e gjykimit të themelit, të filluar që në datën 21.01.2022, duke cenuar interesat e saj. Megjithatë, vijon ajo, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka rrëzuar kërkesën për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave, duke e justifikuar vonesën me ngarkesën e jashtëzakonshme të gjykatës së apelit dhe të gjyqtarit relator.

12. Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit, ka prapësuar se pretendimi i kërkueses është i pabazuar, pasi mosveprimi i gjykatës së apelit nuk ka ardhur për shkaqe subjektive, vlerësime ose qëndrime abuzive të gjyqtarit relator, por për shkak të pamundësisë objektive të gjykatës së apelit, si pasojë e ngarkesës së lartë të çështjeve dhe numrit të reduktuar të gjyqtarëve. Sipas këtij subjekti, në rastin konkret janë marrë masat e nevojshme organizative, duke u përcaktuar kritere transparente dhe objektive për shqyrtimin e çështjeve sipas radhës së vjetërsisë së regjistrimit të tyre, ndërsa përshpejtimi i shqyrtimit të çështjes së kërkueses do të cenonte barazinë në trajtimin e çështjeve të tjera që ndodhen në kushte të ngjashme. Po sipas Avokaturës së Shtetit, kërkuesja nuk ka parashtruar dhe provuar rrethana që dëshmojnë se vonesa rrezikon në mënyrë të konsiderueshme interesat e saj, për sa kohë që mosmarrëveshja lidhet me interesa pronësorë vetjakë dhe jo me interesa jetësorë që kërkojnë shqyrtim me prioritet nga gjykata.

13. Neni 42 i Kushtetutës parashikon, ndër të tjera, se kushdo për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese dhe ligjore ka të drejtën e një gjykimi brenda një afati të arsyeshëm. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar se kohëzgjatja e gjykimit, normalisht, llogaritet nga momenti i fillimit të procesit gjyqësor deri në dhënien e vendimit dhe se në kohëzgjatjen e përgjithshme të gjykimit nuk përjashtohen vonesat e shkaktuara nga zbatimi i reformës në drejtësi, pasi barra e këtyre vonesave nuk duhet të zhvendoset te palët ndërgjyqëse (*shih vendimet nr. 61, datë 21.10.2025; nr. 57, datë 17.09.2024; nr. 33, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Gjykata vëren se procesi gjyqësor, në kuadër të të cilit kërkuesja pretendon cenimin e së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, ka filluar në datën 21.01.2022, me paraqitjen e padisë së saj për njohjen e së drejtës së pronësisë mbi pjesën e pasurisë së përfituar nga e paditura M.D.(H.) nëpërmjet kontratës së privatizimit të datës 06.10.1993, konstatimin e pavlefshmërisë së pjesshme absolute të akteve të praktikës së privatizimit, përkatësisht të formularit nr. 2 dhe të

kontratës së privatizimit, rregullimin e pasojave të pavlefshmërisë dhe fshirjen e emrit të së padituresë nga kartela e pasurisë së paluajtshme.

15. Në datën 05.02.2024, rreth dy vjet pas regjistrimit të çështjes, kërkuesja i është drejtuar Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm nga gjykata e shkallës së parë dhe përshpejtimin e gjykimit. Me vendimin nr. 30-2024-1800 (276), datë 11.03.2024, gjykata e apelit ka vendosur rrëzimin e kërkesës, duke vlerësuar se nuk vërehej ndonjë zvarritje e qëllimshme e procesit nga gjyqtari relator dhe se mosveprimi i gjykatës nuk lidhej me shkaqe subjektive, vlerësime ose qëndrime abuzive të saj.

16. Ndërkohë, në datën 06.11.2024, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes, bazuar në nenin 299, shkronja "ç", të KPC-së, për shkak të mosparaqitjes së paditëses (kërkueses) dhe përfaqësuesit të saj në seancë gjyqësore, megjithëse ata kishin dijeni për zhvillimin e saj nga seanca e mëparshme. Kundër këtij vendimi kërkuesja ka paraqitur ankim të veçantë, mbi bazën e të cilit, në datën 18.02.2025, çështja është regjistruar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me nr. 21246-00770-30-2025.

17. Në vijim, me kërkesat e datave 18.03.2025, 07.04.2025 dhe 28.04.2025, kërkuesja i është drejtuar gjykatës së apelit, gjyqtarit relator, për përshpejtimin e shqyrtimit të ankimit të veçantë të saj. Duke pretenduar se ky ankim duhej të shqyrtohej brenda 30 ditëve, sipas nenit 470, pika 3, të KPC-së, në datën 04.06.2025 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e gjykimit të ankimit nga gjykata e apelit.

18. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-3009, datë 16.07.2025, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkueses. Sipas atij kolegji, mosveprimi i gjykatës së apelit nuk ka ardhur për shkaqe subjektive, vlerësime ose qëndrime abuzive të gjyqtarit relator, i cili ndjek kriterin kronologjik të regjistrimit të çështjeve dhe në atë kohë ishte duke shqyrtuar dhe planifikuar për gjykim çështje të vitit 2017. Kolegji Civil ka vlerësuar se në rastin konkret nuk ka shkelje të afatit të arsyeshëm, për sa kohë që vonesa është shkaktuar nga rrethana objektive që kanë sjellë pamundësinë për procedimin e çështjes.

19. Gjykata, referuar shkaqeve të ankimit kushtetues individual, vëren se kërkuesja e ka mbështetur pretendimin për cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm në mosrespektimin e afatit 30-ditor të parashikuar nga neni 470, pika 3, i KPC-së. Megjithatë, kjo

dispozitë rregullon shqyrtimin e ankimeve të veçanta kundër vendimeve të ndërmjetme. Sipas nenit 127 të KPC-së, vendimet për pushimin e çështjes janë vendime jopërfundimtare, pasi i japin fund procesit gjyqësor civil pa e zgjidhur çështjen në themel. Ndërsa neni 301 i KPC-së parashikon se kundër vendimit për pushimin e gjykimit lejohet ankim i veçantë në gjykatën e apelit, neni 471/a i këtij kodi përcakton se ankimet e veçanta kundër vendimeve jopërfundimtare shqyrtohen brenda 30 ditëve nga regjistrimi i tyre në gjykatën më të lartë. Për rrjedhojë, pavarësisht referimit të pasaktë të kërkueses te neni 470, pika 3, i KPC-së, afati i posaçëm 30-ditor është i zbatueshëm edhe për ankimin e saj të veçantë, në bazë të nenit 471/a të këtij kodi.

20. Nga ana tjetër, sipas nenit 399/2, pika 1, shkronja "b", të KPC-së, për qëllimet e përcaktuara në nenin 399/1 të këtij kodi, afati i arsyeshëm për përfundimin e gjykimit civil në apel është dy vjet. Megjithatë, pika 2 e nenit 399/2 parashikon se palët mund të kërkojnë konstatimin e tejzgjatjes së procedurave edhe përpara kalimit të afateve të përgjithshme, duke mbajtur parasysh kompleksitetin e çështjes, objektin e mosmarrëveshjes, sjelljen e organit që kryen procedurat, si dhe të çdo personi tjetër të lidhur me çështjen. Gjykata vëren se parashikimi i afatit të përgjithshëm dyvjeçar për gjykimin civil në apel nuk përjashton zbatimin e afateve të posaçme procedurale, siç është afati 30-ditor për shqyrtimin e ankimeve të veçanta kundër vendimeve jopërfundimtare. Ky afat i posaçëm lidhet me natyrën e këtyre vendimeve, të cilat i japin fund procesit gjyqësor pa e zgjidhur mosmarrëveshjen në themel, ndërkohë që shqyrtimi i ankimit të veçantë ka rëndësi për përcaktimin e mundësisë së vijimit të gjykimit të themelit.

21. Në rastin konkret, Gjykata konstaton se mbi ankimin e veçantë të kërkueses çështja është regjistruar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në datën 18.02.2025. Sipas informacionit të dërguar nga ajo gjykatë me shkresat e datave 16.04.2026 dhe 24.09.2026, në përgjigje të kërkesave të Gjykatës, rezulton se deri në datën 22.09.2026 çështja nuk ishte planifikuar ende për gjykim.

22. Në rrethanat e mësipërme, Gjykata konstaton se procesi gjyqësor, i filluar në datën 21.01.2022, ka vijuar për më shumë se katër vjet, ndërsa ankimi i veçantë, i regjistruar në gjykatën e apelit në datën 18.02.2025, ka mbetur i pashqyrtuar për më shumë se një vit e shtatë muaj, deri në datën 22.09.2026. Për rrjedhojë, afati i posaçëm 30-ditor i parashikuar nga neni 471/a i KPC-së është tejkaluar në mënyrë të konsiderueshme. Gjykata mban parasysh se, ndonëse mjetet procedurale për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e gjykimit zbatohen për çdo shkallë dhe fazë të veçantë të procesit, arsyeshmëria e kohëzgjatjes së tij duhet të

vlerësohet edhe në raport me kohëzgjatjen tërësore të procedurave (*shih vendimet nr. 17, datë 10.04.2025; nr. 68, datë 07.12.2023; nr. 2, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë këndvështrim, Gjykata vëren se, pavarësisht kohës së kaluar nga paraqitja e padisë, kërkuesja nuk ka marrë ende një vendim gjyqësor për themelin e mosmarrëveshjes.

23. Gjykata thekson se tejkalimi i afatit ligjor, ndonëse përbën një tregues të rëndësishëm të vonesës në gjykim, nuk sjell automatikisht konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për gjykim brenda një afati të arsyeshëm. Një konstatim i tillë kërkon vlerësimin e kohëzgjatjes së procedurave në raport me rrethanat konkrete të çështjes dhe kriteret e përcaktuara nga jurisprudenca kushtetuese. Për rrjedhojë, duke mbajtur parasysh tejkalimin e afatit të posaçëm të shqyrtimit të ankimit të veçantë, kohëzgjatjen e gjykimit në apel dhe atë tërësore të procesit gjyqësor, Gjykata do të vlerësojë nëse vonesa e konstatuar është e justifikuar në kuptim të standardit kushtetues të afatit të arsyeshëm.

24. Gjykata ka theksuar se arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurave vlerësohet në dritën e rrethanave të veçanta të çdo çështjeje konkrete dhe të kritereve që lidhen me: (i) sjelljen e kërkuesit; (ii) kompleksitetin e çështjes; (iii) sjelljen e autoriteteve; (iv) rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuesi *(shih vendimet nr. 64, datë 02.06.2026; nr. 21, datë 04.04.2024; nr. 6, datë 16.02.2023 të Gjykatës Kushtetuese).*

25. Për sa u përket kritereve që lidhen me *sjelljen e kërkueses* dhe *kompleksitetin e çështjes,* Gjykata vëren se nuk rezultojnë rrethana që të tregojnë se kërkuesja ka shkaktuar ose ka ndikuar në vonesën e shqyrtimit të ankimit të veçantë. Përkundrazi, ajo ka kërkuar disa herë përshpejtimin e gjykimit dhe ka përdorur mjetin juridik të parashikuar nga nenet 399/1 e vijues të KPC-së, duke iu drejtuar Gjykatës së Lartë. Po ashtu, nga objekti dhe natyra e ankimit të veçantë, i cili lidhet me kontrollin e ligjshmërisë së vendimit për pushimin e gjykimit, nuk rezulton që vonesa në planifikimin e tij për shqyrtim të jetë shkaktuar nga kompleksiteti i çështjes. Edhe Gjykata e Lartë, në vendimin e kundërshtuar, nuk ka identifikuar si shkaqe të vonesës sjelljen e kërkueses ose kompleksitetin e çështjes. Për rrjedhojë, analiza e Gjykatës do të përqendrohet në sjelljen e autoriteteve dhe rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuesja për shkak të vonesës në shqyrtimin e ankimit të veçantë të saj.

26. Në lidhje me *sjelljen e autoriteteve,* Gjykata ka theksuar se shteti ka detyrimin pozitiv të organizojë sistemin gjyqësor në mënyrë të tillë që gjykatat të jenë në gjendje të garantojnë të drejtën e çdo individi për një vendim përfundimtar brenda një afati të arsyeshëm. Ajo ka pranuar

se reforma në drejtësi dhe procesi i rivlerësimit kalimtar, pa mohuar nevojën, rëndësinë dhe përfitimet, kanë krijuar pasoja të ndjeshme në funksionimin e sistemit gjyqësor, veçanërisht për shkak të vakancave dhe ngarkesës së krijuar në gjykata. Megjithatë, Gjykata ka mbajtur qëndrimin se këto rrethana, ndonëse mund të merren në konsideratë në vlerësimin e përgjithshëm të çështjes, nuk mund të shërbejnë, në vetvete, si justifikim i mjaftueshëm për vonesa të tejzgjatura, aq më tepër kur ato kthehen në problem strukturor të organizimit të gjyqësorit. Në raste të tilla, shteti, përmes autoriteteve përgjegjëse, duhet të ndërhyjë me masa efektive ligjore, organizative dhe institucionale për të garantuar realisht të drejtën për gjykim brenda një afati të arsyeshëm (*shih vendimet nr. 64, datë 02.06.2026; nr. 68, datë 07.12.2023; nr. 35, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Duke iu kthyer rastit konkret, Gjykata vëren se Gjykata e Lartë, në vendimin e kundërshtuar, e ka justifikuar vonesën në shqyrtimin e ankimit të veçantë të kërkueses me pamundësinë objektive të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për shkak të ngarkesës së lartë të çështjeve dhe numrit të pamjaftueshëm të gjyqtarëve, duke vlerësuar se kjo problematikë është e përgjithshme dhe tejkalon rastin konkret. Gjykata, duke mbajtur parasysh jurisprudencën e saj në çështje të tjera të kësaj natyre, rithekson se vështirësitë strukturore të sistemit gjyqësor nuk mund të shërbejnë, të vetme, si justifikim i mjaftueshëm për tejzgjatjen e procedurave gjyqësore. Standardi i nenit 42 të Kushtetutës nuk kufizohet te mungesa e fajit subjektiv të gjyqtarit relator ose të gjykatës kompetente, por përfshin edhe detyrimin e shtetit për të organizuar dhe administruar sistemin gjyqësor në mënyrë të tillë që çështjet të shqyrtohen brenda afateve të arsyeshme (*shih vendimin nr. 64, datë 02.06.2026 të Gjykatës Kushtetuese*). Në rastin konkret, ky detyrim merr rëndësi të veçantë për shkak të natyrës së ankimit të veçantë dhe afatit të posaçëm të parashikuar nga ligji për shqyrtimin e tij. Për rrjedhojë, fakti se vonesa lidhet me shkaqe strukturore nuk e përjashton përgjegjësinë kushtetuese të autoriteteve publike për garantimin efektiv të kësaj të drejte dhe nuk mund të shërbejë si bazë e mjaftueshme për rrëzimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm.

28. Për sa i përket kriterit të *rëndësisë së asaj që rrezikon kërkuesja,* Gjykata ka theksuar në jurisprudencën e saj se disa çështje që lidhen me interesa "vetjakë e jetësorë" kërkojnë trajtim me shpejtësi e përparësi, ku si të tilla janë, ndër të tjera, çështjet që lidhen me statusin civil, kujdestarinë e fëmijëve, marrëdhëniet e punësimit, sëmundjet e pashërueshme, pensionin etj., edhe pse kjo listë nuk mund të jetë shteruese dhe interesi i kërkuesit verifikohet rast pas rasti *(shih*

vendimet nr. 43, datë 04.06.2024; nr. 21, datë 04.04.2024; nr. 6, datë 16.02.2023 të Gjykatës Kushtetuese). Në lidhje me mosmarrëveshjet që kanë për objekt të drejtën e pronës private, Gjykata ka theksuar se kjo e drejtë përbën një nga shtyllat kryesore ku mbështetet sistemi ekonomik dhe zhvillimi i vendit (*shih vendimin nr.1, datë 06.02.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Duke mbajtur në vëmendje rëndësinë kushtetuese të së drejtës së pronës private, nga e cila burojnë edhe të drejtat për ta gëzuar dhe disponuar pasurinë, kohëzgjatja e procedurave gjyqësore merr rëndësi në drejtim të asaj që rrezikojnë palët në procesin gjyqësor (*shih vendimin nr. 46, datë 03.10.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Po ashtu, duke iu referuar edhe jurisprudencës së GJEDNJ-së, Gjykata është shprehur se një periudhë e gjatë mosveprimi nuk mund të konsiderohet kohë e arsyeshme dhe se palët në mosmarrëveshjet civile, edhe kur çështja nuk kërkon ndonjë trajtim të veçantë prioritar, kanë megjithatë të drejtën, sipas nenit 6, pika 1, të KEDNJ-së, për një proces brenda një afati të arsyeshëm, pa qenë të detyruara të tregojnë, për këtë qëllim, se u është shkaktuar ndonjë dëm i veçantë ose shtesë nga vonesat procedurale (*shih vendimin nr. 54, datë 09.10.2025 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Në rastin konkret, mosmarrëveshja e paraqitur përpara gjykatave të zakonshme lidhet me mbrojtjen e së drejtës së pronës private, pasi kërkuesja ka vënë në diskutim vlefshmërinë e akteve të privatizimit të një banese, mbi të cilën pretendon të drejtën e bashkëpronësisë në masën 1/2-ën. Pavarësisht se padia është paraqitur në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë që në datën 21.01.2022, kërkuesja nuk ka ende një vendim për themelin e mosmarrëveshjes, pasi gjykata e shkallës së parë ka vendosur pushimin e gjykimit. Ky vendim është kundërshtuar me ankim të veçantë, i cili është ende në pritje për t'u shqyrtuar në gjykatën e apelit. Për rrjedhojë, vonesa në shqyrtimin e ankimit të veçantë pengon vijimin e procesit të themelit, pasi, edhe në rast të pranimit të tij, çështja do të duhet të rikthehet në gjykatën e shkallës së parë për shqyrtimin e kërkimeve të padisë. Në këto rrethana, duke mbajtur parasysh edhe mundësinë e vijimit të procesit gjyqësor në shkallë të tjera të gjykimit, kohëzgjatja e procedurave, e vlerësuar në tërësinë e saj, merr rëndësi të veçantë për interesin e kërkueses në zgjidhjen përfundimtare të mosmarrëveshjes dhe mbrojtjen efektive të së drejtës së pronës që ajo pretendon.

31. Për sa më sipër, Gjykata, duke vlerësuar tejkalimin e konsiderueshëm të afatit të posaçëm për shqyrtimin e ankimit të veçantë, kohëzgjatjen tërësore të procesit gjyqësor, natyrën e mosmarrëveshjes dhe pasojat që sjell vonesa për interesat e kërkueses, çmon se rrethanat konkrete

justifikojnë shqyrtimin me përparësi të çështjes nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm. Në këtë drejtim, Gjykata mban parasysh se respektimi i radhës kronologjike të gjykimit përbën, në parim, një kriter objektiv për administrimin e drejtë të ngarkesës gjyqësore dhe garantimin e barazisë ndërmjet palëve ndërgjyqëse. Megjithatë, respektimi i kësaj radhe nuk mund të shërbejë si bazë e vetme për rrëzimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurës, pasi një qasje e tillë do ta bënte joefektiv mjetin e posaçëm procedural të parashikuar nga nenet 399/1 e vijues të KPC-së (*shih vendimin nr. 64, datë 02.06.2026 të Gjykatës Kushtetuese*). Në rastin konkret, zbatimi i këtij kriteri duhet të vlerësohet duke mbajtur parasysh edhe natyrën e ankimit të veçantë dhe afatin e posaçëm të përcaktuar nga ligjvënësi për shqyrtimin e tij. Po kështu, ngarkesa e gjykatës së apelit dhe vështirësitë organizative të sistemit gjyqësor nuk përbëjnë *per se* justifikim të mjaftueshëm për vonesën e konstatuar.

32. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, duke e mbështetur rrëzimin e kërkesës së kërkueses kryesisht në pamundësinë objektive të gjykatës së apelit, nuk u ka dhënë peshën e duhur rrethanave konkrete të çështjes, veçanërisht natyrës së ankimit të veçantë, afatit të posaçëm të shqyrtimit të tij dhe pasojave të vonesës për vijimin e procesit gjyqësor. Për të njëjtat arsye, Gjykata nuk i gjen të bazuara as prapësimet e Avokaturës së Shtetit, që mbështeten në pamundësinë objektive të gjykatës së apelit dhe respektimin e radhës kronologjike të shqyrtimit të çështjeve. Në këto kushte, Gjykata arrin në përfundimin se kërkueses i është cenuar e drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, ndaj vendimi nr. 00-2025-3009, datë 16.07.2025 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë duhet të shfuqizohet. Gjithashtu, për arsyet e mësipërme dhe duke mbajtur parasysh natyrën vazhduese të shkeljes, Gjykata vlerëson se Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm duhet të marrë masat e nevojshme për shqyrtimin me përparësi të ankimit të veçantë të kërkueses.

C. Për shpenzimet gjyqësore

33. Kërkuesja ka kërkuar edhe detyrimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për mbulimin e shpenzimeve për shërbimin e avokatit në shumën 50.000 lekë, nga të cilat 25.000 lekë për përgatitjen e kërkesës drejtuar Gjykatës së Lartë dhe 25.000 lekë për përgatitjen e ankimit kushtetues individual në Gjykatë.

34. Neni 28 i Ligjit Organik të Gjykatës parashikon rregullat për shpenzimet gjyqësore. Sipas pikës 1 të tij, shpenzimet e procesit gjyqësor përpara Gjykatës u nënshtrohen rregullave të

parashikuara në ligjin për tarifat gjyqësore, ndërsa, sipas pikës 2, kur vendos pranimin e ankimit kushtetues individual, Gjykata mund të shprehet edhe për shpenzimet e përfaqësimit, pjesërisht ose tërësisht, nëse kjo kërkohet nga kërkuesi. Ky parashikim është konkretizuar në nenin 14, pika 4, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës, sipas të cilit, kur vendoset pranimi i ankimit kushtetues individual, Gjykata shprehet në dispozitiv edhe për shpenzimet e përfaqësimit dhe masën e tyre, nëse kjo është kërkuar nga kërkuesi.

35. Gjykata ka vlerësuar se çështja e shpenzimeve të përfaqësimit në gjykimin kushtetues të ankimit individual është, në parim, pjesë e procesit të rregullt ligjor dhe se refuzimi për mbulimin e tyre rrezikon të kufizojë në mënyrë të pajustifikuar të drejtën për akses në gjykatë. Mbulimi i këtyre shpenzimeve kërkon paraqitjen e një kërkese formale, e cila mund të paraqitet së bashku me ankimin kushtetues individual ose gjatë gjykimit, deri në deklarimin e mbylljes së seancës plenare, si dhe vërtetimin nga individi se ato janë kryer, kanë qenë të nevojshme dhe janë në masë të arsyeshme, përmes paraqitjes së dokumentacionit përkatës, të shoqëruar me fatura tatimore të lëshuara sipas legjislacionit në fuqi. Në përcaktimin e masës së arsyeshme të shpenzimeve mbahen parasysh kompleksiteti i çështjes, niveli i formimit dhe përvoja juridike e kërkuesit për të kuptuar çështjen, mosha dhe gjendja e tij financiare, si dhe rrethana të tjera që ndikojnë në vlerën e kërkuar. Po ashtu, Gjykata ka theksuar se ajo shqyrton vetëm kërkesat për shpenzimet e përfaqësimit përpara saj, ndërsa shpenzimet e kryera në secilën shkallë të gjykimit të zakonshëm kërkohen përpara gjykatave kompetente. Përgjegjësia për mbulimin e shpenzimeve të përfaqësimit në gjykimin kushtetues i takon shtetit, për shkak se në këtë gjykim individi kërkon mbrojtjen e të drejtave themelore të shkelura si pasojë e veprimtarisë së autoriteteve publike, përfshirë gjykatat e zakonshme (*shih vendimin nr. 47, datë 18.09.2025 të Gjykatës Kushtetuese*).

36. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Gjykata vëren se kërkuesja e ka paraqitur kërkimin për mbulimin e shpenzimeve të përfaqësimit në ankimin kushtetues individual, duke i bashkëlidhur faturën tatimore të lëshuar nga avokati për shërbimin "*Kërkesë drejtuar Gjykatës Kushtetuese*", në vlerën 25.000 lekë. Kjo shumë përputhet me vlerën e parashikuar në udhëzimin e përbashkët nr. 18, datë 05.08.2020 të ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Financave "Për miratimin e kritereve të përfitimit të pagesave dhe tarifat e shpërblimit të avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike dytësore" për shërbimin juridik jashtëgjyqësor të përgatitjes së kërkesës. Duke mbajtur parasysh dokumentacionin e paraqitur dhe natyrën e çështjes konkrete, Gjykata vlerëson se shpenzimi i kërkuar për përgatitjen e ankimit kushtetues individual është i provuar, i nevojshëm dhe në masë

të arsyeshme. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se kërkimi për mbulimin e këtij shpenzimi është i bazuar dhe duhet të pranohet në shumën 25.000 lekë, e cila i ngarkohet Ministrisë së Financave. Ndërsa kërkimi për shumën tjetër prej 25.000 lekësh, që lidhet me shërbimin juridik të ofruar në procesin përpara Gjykatës së Lartë, nuk mund të pranohet në këtë gjykim kushtetues, pasi shpenzimet e përfaqësimit të bëra në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm mund të kërkohen përpara gjykatave të zakonshme kompetente.

37. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimi i kërkueses për cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm është i bazuar, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2025-3009, datë 16.07.2025 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
3. Konstatimin e cenimit të së drejtës së kërkueses për gjykim brenda një afati të arsyeshëm nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm në çështjen nr. 21246-00770-30-2025, datë 18.02.2025.
4. Shpenzimet e përfaqësimit të kërkueses në vlerën 25.000 lekë i ngarkohen Ministrisë së Financave.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 06.10.2026

Shpallur më 29.10.2026